



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 4.5 të Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 3.1 Rregullës Zgjedhore nr.15/2013 për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parkohëshme, si dhe duke bazuar në vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës Nr.254/2019 të datës 08.04.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e mbajtur me datën 08.04.2019, nxjerrë këtë:

VENDIM

Për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore sipas Rregullës Zgjedhore nr.15/2013 për zgjedhjet e jashtëzakonshme në Komunitet Leosaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut – 19 Maj 2019

- I. Miratohet vendimi për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme në komunitet Leosaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, të cilat do të mbahen me datë 19 maj 2019.
- II. Afatet kohore për zbatimin e të gjitha aktiviteteve zgjedhore që ndërlidhen me zgjedhjet e jashtëzakonshme, i referohen afatit prej 40 (katërdhjetë) ditë, si në vijim:
 - a) Afati për krijimin e Listës së Votuesve, periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit do të filloj me datë 3 maj dhe do të përfundoj më datë 9 maj 2019;
 - b) Aplikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve do të filloj me datë 9 prill dhe do të përfundoj me datë 18 prill 2019;
 - c) Certifikimit dhe publikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve do të bëhet me datë 22 prill 2019;
 - d) Afati i fundit për tërheqje të kandidatëve nga shorti i fletëvotimit dhe afati i zëvendësimit të kandidatëve është data 26 prill 2019;
 - e) Afati për hedhjen e shortit të fletëvotimit, do të mbahet me datë 28 prill 2019;
 - f) Afati i fundit për të caktuar kufizimin e shpenzimeve për fushatë është data 12 prill 2019;
 - g) Fushata zgjedhore si dhe afatet për tubimet zgjedhore do të fillojnë me datë 13 maj dhe do të përfundojnë me datë 17 maj 2019;

- h) Dorëzimi i kërkesës për akreditimin e organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe vëzhgueseve do të fillojë me datë 9 prill 2019 dhe do të përfundoj me datë 12 maj 2019;*
 - i) Emërimet e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) do të bëhet me datë 15 prill 2019;*
 - j) Periudha e shërbimit të votuesve do të fillojë me datë 23 prill dhe do të përfundoj me datë 29 prill 2019;*
 - k) Certifikimi i listës së votuesve do të bëhet me datë 13 maj 2019;*
 - l) Emërimet e Këshillave të Vendvotimeve do të fillojnë me datë 2 maj dhe do të përfundoj me datë 4 maj 2019;*
 - m) Publikimi i Qendrave të Votimit do të bëhet me datë 9 maj 2019;*
 - n) Aplikimi për regjistrim si votues jashtë Kosovës do të filloj me datë 25 prill dhe do të përfundoj me datë 30 prill 2019;*
 - o) Aplikimi për regjistrim si votues me nevoja të veçanta do të filloj me datë 9 maj dhe do të përfundoj me datë 13 maj 2019;*
- III. Caktimi i afateve sipas nenit I të këtij vendimi, do të vlejë për zgjedhjet e jashtëzakonshme në Komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut;
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nëshkrimit.

Prishtinë, 8 prill 2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Valdete Daka